

Teksti prej 150 fjalë

PSD-ja është forcë politike e cila angazhohet për një qasje njerëzore dhe të civilizuar në zgjedhjen e problemeve të qytetarëve të Kosovës. Politika e PSD-së është e bazuar në parimet e humanizmit, etikës njerëzore dhe demokracisë sociale.

Pikëpamja socialdemokrate mbi shoqërinë është shprehje e synimit për të përmbushur idetë e lirisë, barazisë, demokracisë dhe solidaritetit. PSD synon mbrojtjen dhe konsolidimin e lirive qytetare nëpërmjet çlirimit të njerëzve nga inferioriteti ekonomik, kulturor dhe social, si dhe përmes eliminimit të varësisë së tyre nga grupet e interesit të krijuara në bazë të pushtetit dhe statusit ekonomik individual.

Ne angazhohemi për liri, barazi, drejtësi dhe solidaritet të qytetarëve të bazuar në parimet e demokracisë dhe të tregut të lirë. Synojmë ofrimin e mundësive të barabarta për njerëz pa dallim të përkatësisë politike, gjinore, fetare ose nacionale.

Socialdemokracia lufton për barazi me bindjen së të gjithë njerëzit kanë vlerat dhe dinjitetin e tyre.